

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, permes gjykatsit Shabi Idrizi dhe sekertarja juridike Shpresa Hoxha , në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Kaçanik ,për shkak te veprës penale rrezikimi I trafikiut publik nga neni 378parag. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-Ferizaj, PP/II.nr.281-6/15 të dt. 28.01.2016, me dt.12.12.2016, pa mbajtje të shqyrtimit gjyqsor, morri këtë;

A K T G J Y K I M

PRANOHET, propozimi i PTH-së nga Ferizaji i dt. 28.01.2016, gjykata lëshon këtë:

U R D H Ë R N D E S H K I M O R

I Pandehuri [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Kaçanik, i lindur më dt. [REDAKTUAR], në fsh. [REDAKTUAR] nga babai [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR] shqiptar shtetas i Republikës Kosovës ,ka të kryer shkollën fillore, I gjendjes së varfër ekonomike,me nr personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri.

Ë s h t ë f a j t o r

Me datën 16.02.2015 rreth ores 13.10.në magjistralen Kaçanik-Ferizaj,afër rrugës për në fshatin [REDAKTUAR] komuna Kaçanik,duke drejtuar automjetin e markës"Opel Vectra"ngjyre të kuqe,me targa të regjistrimit [REDAKTUAR],nga pakujdesia duke vepruar në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR ka rrezikuar trafikun publik dhe jeten e njerzve ,në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësin e lëvizjes dhe kushteve në rrugë,në atë mënyrë që gjeri sa në shiritin e kundërt qarkullues ishin duke punuar në rrugë me ç'rast vetura e markës"Mercedes",me targa [REDAKTUAR] ngjyrë e kaltërt të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] ishte ndaluar për shkak të pengesave në rrugë vetura,, Opel Vectra"në pamundësi për tu ndalur edhe pse kishte frenuar e kishte goditur me pjesën e parë në pjesën e pasme veturën"Mercedes",ku përveq dëmeve material në të dy automjetet lëndime të lehta trupore ka pësuar [REDAKTUAR] dhe atë përdredhja të qafës me pasoja të përkoshme për shëndetin,

Me këtë veprim ka kryer veprën penale rrezikimi I trafikiut publik nga neni 378parag. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj Gjykata duke u bazuar ne dispozitat e neneve 2,3,17,41,46 të KPK-së dhe nenin 495 te KPPK-së

I shqipton

Denim me gjobe ne shumë prej 250 euro te cilën i pandehuri ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi në 3 kiste mujore, në të kundërtën i njëjti do i zëvendsohet denim me burg ashtu që 20 euro gjobë do i llogaritet një ditë burg.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 78.50 euro.

Arsyetim

PTH- Ferizaj me Aktakuzën e vet PP.nr. 281-6/15 të dt. 28.01.2016 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] Kaçanik, për veprën penale rrezikimi I trafikut publik nga nenin 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPK së, perfaqesuesi i aktit akuzues ka propozuar që pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqsor të shqiptohet urdhëri ndëshkimor sipas të cilit të akuzuarit të i shqiptohet denimi me gjobë.

Pas shqyrtimit të Aktakuzës dhe kërkesës për dhënjën e urdhrit ndëshkimor, gjykata në baze të provave të bashkangjitura ka gjetur se kërkesa e Pth-Ferizaj, për dhënjën e urdhrit ndëshkimor dhe e shqiptimit të denimit me gjobë është e bazuar, mbështetur në faktin se të dhënat e aktit akuzues dhe provat e bashkangjitura ofrojnë elemente të mjaftushme për dhënjën e urdhrit ndëshkimor pa mbajtur shqyrtim gjyqsor conform nenit 495 të KPPK-së.

PTh-Ferizaj ka pranuar rastin numër 2015-CFT-065 të dt.16.02.2015 prej të cilit gjykata konstaton se i pandehuri [REDAKTUAR] Me datën 16.02.2015 rreth orës 13.10.në magjistralen Kaçanik-Ferizaj,afër rrugës për në fshatin Nikaj komuna Kaçanik,duke drejtuar automjetin e markës"Opel Vectra"ngjyre të kuqe,me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] nga pakujdesia duke vepruar në kundërshtim me nenin 54.1 të LSKRR ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerzve ,në atë mënyrë që nuk ka përshtatur shpejtësinë në lëvizjes dhe kushteve në rrugë,në atë mënyrë që gjeri sa në shiritin e kundërt qarkullues ishin duke punuar në rrugë me ç'rast vetura e markës"Mercedes",me targa [REDAKTUAR] ngjyrë e kaltërt të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] ishte ndaluar për shkak të pengesave në rrugëvetura,, Opel Vectra"në pamundësi për tu ndalur edhe pse kishte frenuar e kishte goditur me pjesën e parë në pjesën epasme veturën"Mercedes",ku përveq dëmeve material në të dy automjetet lëndime të lehta trupore ka pësuar [REDAKTUAR] a dhe atë përdredhja e qafës me pasoja të përkoshme për shëndetin,

Mbështetur në gjendjen faktike në bazë të provave të bashkangjitura gjykata ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit arrihen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi I trafikut publik nga nen 378. par.6 lidhur me par 1 të KPK.

Me rastin e caktimit të lartsisë së denimit për të pandehurin [REDAKTUAR] gjykata morri parsysh rrezikshmerine shoqrore të veprës penale, pasojat e veprës andaj i shqipton denimin me

gjobë në lartësi prej **250 €** i cili denim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe se me këtë lloj denimi do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri dhe do arrihet efekti i denimit në kuptim të nenit 41 të KPK-së.

Gjykata ka obliguar të pandehurin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate si dhe pashallin gjyqsor në vlerë prej **78.50** euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në pajtim me nenet 453 dhe 463 të KPPK-së. Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ -DEGA NË KAÇANIK

P.nr.37/16,Me dt. 12.12.2016

Procesmbajtsja
Shpresa Hoxha

Gjykatësi
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: kunder këtij aktgjykimi ndërhi ndeshkimin e mandet të ushrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit. Kundërshtimi i dërgohet Gjykatës Themelore Ferizaj, Dega në Kaçanik

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLICA OF KOSOVO
VI NENIMI I SHITJE I PLOTFUNKSIONAL
ODI LJKA JE PRAVNOSNAZNAK
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NE KACANIK
OSNOVNI SUD U OBRANAK U KAÇANIK

Me
Data

16.01

20

